FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION
VENDIMET NGA MBLEDHJA E BORDIT TË FGJK-SË

Bordi Ekzekutiv (BE) i FGJK-së, me datë 25 Shtator 2025 duke filluar nga ora 16:00, mbajti mbledhjen e bordit në zyrën e FGJK-së, në Shtëpinë e Sportit në Prishtinë, duke ju përmbajtur rëndit të ditës.

REND I DITËS

1. **Hapja e mbledhjes nga Kryetari:** Mbledhja është hapur nga Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, i cili falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në këtë mbledhje.
2. **Caktimi i një proces-mbajtësi:** Kryetari Z. Maqastena propozoj që procesmbajtës në këtë mbledhje të jetë Sekretari i Përgjithshëm, Z. Amir Tahiraga, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.
3. **Verifikimi i pjesëmarrsëve në mbledhje, numri i tyre:** Në këtë pikë të rendit të ditës, u vërtetua se të gjithë prezent në mbledhje ishin 8 anëtarë me të drejtë vote, gjithashtu prezent ishin edhe Sekretarin e Përgjithshëm, dhe Sekretari Teknik Arlind Shaqirin.

   Të pranishëm në mbledhjë të BE të FGJK-së, ishin:

   1. Shkumbin Maqastena – Kryetar i FGJK-së,
   2. Besim Halilaj – Nënkryetar i FGJK-së,
   3. Sherife Aliçkaj Qerimi – Nënkryetare e FGJK-së,
   4. Elfete Gashi – Anëtare e BE të FGJK-së,
   5. Besnik Latifi – Anëtari BE të FGJK-së,
   6. Lisa Zeqiri – Anëtare e BE të FGJK-së,
   7. Rizonë Mustafa – Anëtare e BE të FGJK-së,
   8. Ard Kryeziu – Anëtar i BE të FGJK-së,
   9. Amir Tahiraga – Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së, pa të drejtë vote.
   10. Arlind Shaqiri – Sekretar Teknik i FGJK-së pa të drejtë vote.
4. Organizimi i Kampionatit të Kosovës, data vendi dhe disiplinat: Pas shumë propozimesh, Bordi Ekzekutiv vendosi që Kampionati i Kosovësn ë gjimnastikë artistike për femra dhe meshkuj të mbahet me datë 6 dhe 7 Dhjetor 2025, duke filluar nga ora 09:00, eventi do të mbahet ne Fakultet të Edukimit Fizik dhe Sporteve, në 3 vegla (mund të nryshoj), parter, kapërcime dhe tra, kurse pjesëmarrës janë 6 kategori të gjimnastëve/eve, Para-Yllka, Yllka, Para-Pioniere, Pioniere, Juniore dhe Seniore. Gara do jetë indviduale dhe ekipore.
5. Organizimi i kursit pë trajner, data e mbajtjes dhe vendi – BE e FGJK-së, pas shumë diskutimesh vendosi që trajnimi për trajner të mbahet me datë 15 dhe 16 Nëntor 2025, Kursi do të mbahet në Hotel Sirius, duke filluar nga ora 10:00. Në ditën e parë do ketë teori, kurse dita e dytë do ketë ndihmë të parë, pastaj praktike dhe ne fund test për pjesëmarrësit, Manuali i këtij trajnimi është përpiluar nga Sekretari Teknik Arlind Shaqiri, i cili përmban Safeguarding në gjimnastikë, Roli i trajnerit, etikë, komunikim, Ushqimi gjumi dhe rikuperimi, Planifikimi i

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

ushtrimeve dhe trajnimi optimal për fëmijët në rritje, Përgatitija fizike për gjimnastikë dhe biomekanika e lëvizjeve, Ndihma e parë, Punime në grupe, mësim i elementeve gjimnastikore në vegla të ndryshme, Testim. **Ky kurs është vetëm për trajnerët dhe ndihmëstrajnerët që janë duke vepru (stërvit) nëpër klube.** FGJK do të dërgoj listën e regjistrimit të trajnerëve, dhe orarin e ligjeratave si dhe ligjeruesit. (nësë ka ndryshim në vendin e mbajtjes së trajnimit do të lajmëroheni me kohë).

6. Rishqyrtimi i vendimit për meditje të brendshme dhe të jashtme – Janë dhënë shumë propozime, dhe në fund është vendosur që kjo pikë të rishqyrtohet në mbledhjet e ardhshme të BE të FGJK-së.
7. Diskutimi për regjistrim të klubeve dhe gjimnastëve në fillim të vitit, shuma e pagesës së regjistrimit – Në këtë pikë të rendit të ditës, Sekretari i Përgjithshëm njoftoj të pranishmit se në mbledhjen e BE të FGJK-së të mbajtur me datë 24/04/2025 është marr vendim që gjimnastët/tet të paguajnë për regjistrim (gymnastics fee) nga 5 euro, dhe se kjo praktikë bie ndesh me planin e aktiviteteve dhe financiare të FGJK-së, dhe pas konsultimeve me hisetarët FGJK duhet që vendimin e datës 24/04/2025, të e shfuqizojë, dhe të marr vendim për kthim të mjeteve klubeve që kanë bërë pagesë për atë garë të Nivelit C. Pas shumë diskutimeve Bordi i FGJK-së, vendosi PËR kthimin e mjeteve, klubeve që kanë paguar për garën e Nivelit C, nuk kishte kundër apo abstenim. Sekretari i FGJK-së, njoftoj të pranishmit për mënyrën e kthimit të mjeteve në klube, dhe se është vendosur unanimisht që mjetet të kthehen në klube fizikisht pa i deponuar mjetet në bankë, duke përpiluar një listë, me numër të vendimit , me numër total të pagesave të klubit me nënshkrim të Kryetarit, Kryetrajnerit të klubit, dhe nënshkrim të Sekretari të Përgjithshëm të FGJK-së. Kurse për regjistrim të klubeve dhe të gjimnastëve/eve në FGJK, do të shqyrtohet ne mbledhjen e ardhshme të FGJK-së.
8. Të ndryshme:, Sekretari i Përgjithshëm njoftoj BE të FGJK-së, se pas punës intensive të FGJK-së kemi arrit që të pranojmë një donacion nga shteti Holandez me vegla gjimnastikore. Kjo është arritur falë angazhimit të madh edhe të Federatës Kroate të Gjimnastikës, dhe të Komitetit Olimpik të Kosovës. Veglat janë paraparë që të nisen nga Holanda me 2 Tetor. BE i FGJK-së është njoftuar gjithashtu për mënyrën e shpërndarjes së veglave nëpër klubet e FGJK-së, dhe pas përpilimit të listës BE e FGJK-së, do aprovoj apo modifikoj listën përfundimtare të shpërndarjes së veglave nëpër klube, dhe se klubet do të njoftohen me kohë për ti pranuar veglat, transportin e veglave nga Pallati i Rinisë dhe Sporteve (ose lokacioni tjetër) deri në klub e benë vetë klubi.

   BE e FGJK-së është njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm se një set i veglave të reja donacion nga Gjimnastika Europiane, është finalizuar, dhe se pritet që edhe këto vegla të arrinë në Kosovë, mirëpo këto vegla do qëndrojnë në depo të FGJK-së, dhe do të përdoren vetëm për gara.

   BE e FGJK-së, pasi diskutimeve, ka marr vendim që çdo ekip që dërgohet për gara jashtë vendit, 3 ditë më herët të mbahet një mbledhje me prindër, trajner dhe gjimnaste, në mënyrë që të informohen prindërit, gjimnastet dhe trajnerët me rregullat e përgjithshme.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

VENDIMET NGA MBLEDHJA E BORDIT TË FGJK-SË

Mbledhja e BE të FGJK-së përfundoi me datë 25/09/2025 në ora 18:30.

Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com